



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 216 Prot

Tiranë, më 24.06.2014

VENDIM Nr. 320, dt. 04.06.2014

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 04.06.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e projektit në vazhdim me karakter kërkimor-shkencor, të paraqitur nga Universiteti i Tiranës,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Projektin Arkeologjik Shkodër (PASH)", bashkëpunim i Universitetit të Tiranës dhe Millsaps College, Mississippi (ShBA), me bashkëdrejtues As. Prof. Lorenc Bejko dhe Michael Galaty për kryerjen e aktivitetit të mëposhtëm kërkimor:
- Kryerja e sondazheve arkeologjike në sitet arkeologjike të zbuluara, apo të mbuluara nga sërveji i mëparshëm i PASH: Kullaj, Gajtan, Vorfë, Rosek, Zagorë, Kratul i Madh.
 - Vazhdimin e vrojtimeve sistematike në atë pjesë të ultësirës së Shkrelit që shkojnë deri në fshatin Lohë e epërme dhe Dedaj.
 - Shtrirja e gërmimeve preventive të tumave (tre të tilla në zonën e Shtojtit sipas Vendimit të KKA 2012) edhe në zonën e Shkrelit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI
MIRELLA KUMBARO FURXHI
MINISTËR

SEKRETARI I KKA
ARTAN PUTO